

Hapet thirrja për aplikime për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin Bordeaux Montaigne, në Francë, në kuadër të programit Erasmus +, për semestrin e parë të vitit akademik 2019-2020.

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin Bordeaux Montaigne në Francë, për semestrin e parë të vitit akademik 2019-2020.

<https://www.u-bordeaux-montaigne.fr/fr/index.html>

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime;

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Bachelor;

- Master;

- Ph.D.;

Kohëzgjatja e mobilitetit:

- Bachelor (1 semestër);

- Master (1 semestër);

- Ph.D. (1 semestër);

Fushat e mobilitetit:

Histori dhe Arkeologji.

Për t'u njohur me katalogun e programit të mobilitetit në fushën e sipërpërmendur dhe gjuhën në të cilën ai zhvillohet, klikoni në adresën:

<http://www.u-bordeaux-montaigne.fr/fr/index.html>

file:///C:/Users/Juli%20Shima/Downloads/courses_foreign_languages_2019.pdf

Mobiliteti përfshin:

- Kompensimin mujor (850 EUR në muaj për studentët);

- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

| DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm) | Kompensimi |
|--|-------------------|
| Midis 100 dhe 499 KM | 180 EUR |
| Midis 500 dhe 1999 KM | 275 EUR |
| Midis 2000 dhe 2999 KM | 360 EUR |
| Midis 3000 dhe 3999 KM | 530 EUR |
| Midis 4000 dhe 7999 KM | 820 EUR |
| 8000 KM ose më shumë | 1100 EUR |

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët Bachelor:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti i nivelit Bachelor (të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze/franceze);
- Listë notash (të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze/ franceze);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze/ franceze);
- Certifikatë e gjuhës së huaj B2 (Anglisht/Frengjisht në varësi të programit të studimit);
- *Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the Mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në universitetin pritës lëndë të njëjta me ato që do të kryeni në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloheni/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:
http://www.unitir.edu.al/images/Learning_agreement_for_studies_Erasmus.docx

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit **Master**:

- CV (në gjuhën angleze/spanjolle);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti të nivelit Master (të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze/ franceze);
- Listë notash e nivelit Bachelor (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/ franceze);
- Listë notash e nivelit Master (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/ franceze);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze/ franceze);
- Certifikatë e gjuhës së huaj B2(Anglisht/Frengjisht në varësi të programit të studimit);
- *Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the Mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në universitetin pritës lëndë të njëjta me ato që do të kryeni në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloheni/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:
http://www.unitir.edu.al/images/Learning_agreement_for_studies_Erasmus.docx

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit **PhD**,

- CV (në gjuhën angleze/ franceze);
- Kopje e Pasaportës;

- Vërtetim studentit të nivelit PhD (të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze/ franceze);
- Listë notash e nivelit Master (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/ franceze);
- Listë notash e nivelit PhD (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/ franceze);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze/ franceze);
- Certifikatë e gjuhës së huaj B2 (Anglisht/Frengjisht në varësi të programit të studimit) ;
- *Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘‘Before the Mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në universitetin pritës lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni/frekuentoni lëndët që nuk përshatën në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti ‘‘Learning Agreement’’ tek seksioni ‘‘Commitment’’ firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Learning_agreement_for_studies_Erasmus.docx

Afati për aplikim: 27 Qershor 2019

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!